

VENDIM
Nr.64, datë 22.9.2009

**PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA
ERE SHOQËRISË UNION EOLICA ALBANIA SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë Union Eolica Albania sh.p.k,

Dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikes që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1, germa “a” dhe “d” të vendimit nr.88, datë 6.8.2008 “Për licencimin e shoqërisë Union Eolika Albania sh.p.k.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta